



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.144/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllgjani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 02.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.144/2019 e datës 30.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 30.09.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 30.09.2019, rreth orës 12:26, në Komunën e Suharekës, përkatësisht në Rr.”Brigada 123”, në afërsi të shkollës “ 7 Marsi”, është parë një poster i vendosur në një distancë jo më larg se 40 metra nga shkolla në fjalë, i cili poster i takon njërit nga kandidatët për deputetë nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht dispozitën e nenit 3 par.3, pika 4, të kësaj rregulle zgjedhore.

Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të posterit të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Salih Zyba, në cilësi të provës materiale.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka konsideruar se ankesa është e pabazuar, duke theksuar se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Salih Zyba, për vendosjen e billbordit ka lidhur kontratë me kompaninë për reklamim “DHHED”, me adresë në Suharekë, Rr”Brigada 123”, më datë 25.09.2019. Sa i përket pretendimeve të paraqitësit të ankesës se billbordi është vendosur në afërsi të shkollës fillore, paraqitësi i përgjigjes në ankesë, ka bërë interpretimin e nenit 3 par.3, pika 4, të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, duke theksuar se pjesa e parë e këtij neni ka të bëjë me ndalesën e materialit zgjedhor brenda hapësirave publike, ndërsa pjesa e dytë e kësaj dispozite ka të bëjë me ndalesën e materialit zgjedhor brenda qendrave të votimit ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metrash nga hyrja e tyre. Më tej ka shtuar se jo çdo shkollë mund të jetë qendër votimi ditën e zgjedhjeve, sipas Rregullës Zgjedhore Nr.09/2013, respektivisht nenin 2 të kësaj rregulle, duke konsideruar se 100 metra nga hyrja e vendvotimit duhet të interpretohet natyrshëm me nenin 36 par.1, pika a), lidhur me nenin 8 par.1, pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, dhe me pretendimin se paraqitësi i ankesës e keqinterpreton nenin 3 par.3, pika 4 të rregullës së lartcekur zgjedhore. Sipas paraqitësit të përgjigjes në ankesë, kjo dispozitë ligjore nuk përcakton ndalesën e vendosjes së billbordeve më afër se 100 metra gjatë fushatës, afër objekteve shkollore, por gjatë heshtjes dhe procesit

të votimit, dhe për më tepër në asnjë nga dispozitat e LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore, nuk përcaktohen pretendimet e shkeljes ligjore që pretendon paraqitësi i ankesës. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti politik në fjalë i është referuar praktikës gjyqësore të PZAP-it, respektivisht vendimit të evidentuar si Anr.109/2019, duke propozuar në fund që ankesa e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, të refuzohet si e pabazuar.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë, si dëshmi për pretendimet e tij, ka bashkangjitur një kopje të kontratës, lëndë e së cilës është dhënia me qira e hapësirave reklamuese.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, siç pretendohet në ankesë, sepse billbordi i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim të materialit propagandistik për fushatë zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterit i kandidatit në fjalë, është vendosur 40 metra larg nga shkolla fillore “7 Marsi”, në Suharekë, në hapësira apo vende publike, Paneli vlerëson se në një rast të tillë, ky veprim, në këtë kohë, nuk përbën shkelje të rregullës zgjedhore të sipërcituar, për faktin se sipas Rregullës Zgjedhore, Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, në nenin 1, ndër të tjera përcaktohet se: *”Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë: organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, përmbajtjen e materialeve të shtypura të fushatës zgjedhore, rastet e veprimeve para ditës së zgjedhjeve ...”*, nga rezulton se këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore siç pretendon paraqitësi i ankesës ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti afër të cilit pretendohet se është vendosur billbordi, shërben si Qendër e Votimit, ku sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 144/2019 më datën 02.10.2019

Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gillogjani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.